



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kaçanik
Municipality of Kaçanik

01Nr. 07-104/02-13623/25
Kaçanik, 30.06.2025

Në bazë të nenit 11, 12.2 (c) lidhur me nenin 40.2(a) dhe 17(f) të Ligjit nr. 03/L – 040 për Vetëqeverisjen Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 28/2008, 04 Qershor 2008), nenit 6 të Ligjit nr. 04/L-179 për Transportin Rrugor (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.21 e datës 13 qershor 2013), të nenit 34.5 lidhur me nenin 6.2 (f) të Statutit të Komunës së Kaçanikut (teksti i spastruar sipas Statutit 01Nr.60/01-12895/20 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Statutit të komunës së Kaçanikut 01Nr.3588/2008), Kuvendi i Komunës Kaçanik, në mbledhjen e mbajtur më 30 qershor 2025 mori këtë:


VENDIM

PËR APROVIMIN E RREGULLORES NR.03/2025 - PËR TRANSPORTIN RRUGOR NË TERRITORIN E KOMUNËS SË KAÇANIKUT

1. Me këtë Vendim, Aprovohet Rregullorja për transport rrugor në territorin e komunës së Kaçanikut.
2. Qëllimi i rregullores nga pika I e këtij vendimi, është rregullimi dhe zhvillimi i sektorit të transportit rrugor të udhëtarëve dhe mallrave brenda kufijve administrativ të komunës së Kaçanikut.
3. Rregullorja është hartuar nga Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Emergjencave, përmban gjithsej 88 nene e përmbledhur në 22 faqe, dhe është pjesë përbërëse e këtij vendimi.
4. Për zbatimin e rregullores është përgjegjëse, Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Emergjencave dhe Inspektorati komunal.
5. Rregullorja hyn në fuqi 30 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të autoritetit mbikëqyrës-MAPL dhe 7 ditë pas publikimit në faqen zyrtare të komunës dhe në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Me këtë vendim njoftohen:

1. Kryetari i Komunës (përmes Zyrës së Kryetarit njoftohen Zyra e Inspektoratit Komunal dhe mekanizmat tjerë relevantë);
2. Drejtoria e Shërbimeve publike dhe Emergjencë;
3. Drejtoria e Buxhetit dhe Financave;
4. Arkivi.



Kryesuesi i Kuvendit
Kemal Murseli